

Rregjistrimi i martesës

Martesa rregjistrohet në Zyrën e Gjëndjes Civile të vendbanimit të nuses ose të dhëndrit.

* Për lidhje martese duhet që bashkëshortet, si vajza dhe djali të kenë mbushur moshën 18 vjeç

* Përpara lidhjes së martesës, nëpunësi i Gjëndjes Civile bën shpalljen e saj. Për këtë duhet të paraqiten pranë zyrës të dy bashkëshortët të cilët duhen të paraqitin një kërkesë dhe dy çertifikata lindje me shënimin “për shpallje martese”

* Lidhja e martesës (celebrimi) bëhet pas 10 ditësh. Të dy bashkëshortët duhet të dorëzojnë çertifikatë për lidhje martese dhe fotokopje të ID. Afati i lidhjes së martese është deri 1 vit nga dita e shpalljes së martesës.

Në rastin kur njeri nga bashkëshortët është shtetas i huaj dhe lidhja e martesës bëhet pranë një zyre të gjëndjes civile në Shqipëri, procedura është e njëjtë:

* Të dy bashkëshortët duhet të jenë prezent për shpalljen e martesës, shtetasi i huaj duhet të ketë çertifikatë lindje dhe një dokument nga gjëndja civile e qytetit ku jeton, ku të vërtetohet leja e martesës dhe rezidenca, që ai ose ajo është i lirë për të kryer martesë.

* Këto dokumenta duhet të jenë të legalizuara nga Ministria respektive dhe Prefektura, dhe me vendet që kanë hyrë në Konventën e Hagës duhet vulë Apostile.

* E njëjta procedurë ndiqet edhe për lidhje martese të një shtetasi(e) në një vend të huaj. Edhe në këtë rast bëhet shpallja e martesës në gjëndjen civile në Përmet dhe mbas afatit 11ditor, personi i interesuar pajiset me një çertifikatë për lidhje martese në shtetin tjetër.